




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 67 datë 28.10, 2022



**“Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 2.0 ha “për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimitari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj)” në ekonominë pyjore Gomsiqe .**

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, neni 18 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 57/2020, date 30.4.2020 “Për Pyjet”, neni 25, **pika 49** e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënje në përdorim të fondit pyjor dhe kulloror publik” **me shumicë të cilësuar votash:**

V E N D O S I

1. Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes në total prej 2.0 ha “Për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për vëprimitari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj)”, ku në ngastrën nr.2a me sipërfaqe prej 0.855 ha dhe në ngastrën nr.2b në sipërfaqe prej 1.145 të ekonomisë pyjore Gomsiqe.
2. Afati i dhënies me qera të jetë 10 (dhjetë) vjet me të drejtë rinovimi.
3. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM-së nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për vëprimitari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”, Shtojca 1, pika 6/3.
4. Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti , sigurohen të ardhura të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
5. Ngarkohen Drejtoria e Pyjeve, Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

K R Y E T A R  
Mark Bisha

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
Ardian Çelepija

Miratuar me 21 vota

Vota Pro 21

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 02.11 2022





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 736/1.prot.

Shkodër, më 11.11.2022

Nr. 6178/ Prot

Dt. 16.11.22



**LËNDA: Mbi vendimin Nr.67 datë 28.10.2022 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.**

**KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS**

Për Informim: **ZYRES SE ADMINISTRIMIT TE BASENIT UJOR DRIN-BUNE**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175, datë 9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu II, neni 4, nenit 9, pika 1/1.2 germa a dhe c, nenit 27 pika 5, nenit 54 shkronja e/1, nenit 55 pikat 3 të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, ligjit Nr.57/2020 “Për pyjet” neni 25/1/a, VKM Nr.433 datë 08.06.2016 “Për Transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive” i ndryshuar, pika 49, shtojcës nr.47, VKM Nr.559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike si dhe për prodhime drusore dhe jo drusore pyjore”, Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.1 datë.9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkitimit, të shyrimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjorë dhe kullësor publik”, pika 2 germa a, dhe pika 7, VKB Vau-Dejës Nr.6 datë 26.01.2022 “Për miratimin e listës të ngastrave dhe nëngastrave pyjore të gatshme për dhënie në përdorim”, dokumentacionin shoqërues të mbledhjes së Këshillit Bashkia Vau-Dejës te datës 28.10.2022, dërguar nga Sekretari i Këshillit bashkiak Vau-Dejës Nr.6175.prot datë 2.11.2022, u shqyrtua VKB Nr.67 datë 28.10.2022 Vau-Dejës “Për dhënie në përdorim me afat 10-vjeçar<sup>1</sup> të sipërfaqes pyjore prej 2.0 ha (total) të ekonomisë pyjore Gomsiqe (ngastra nr.2a dhe 2.b) “Për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive , shplodhëse, kulturore etj.....”.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedim konform procedurave të mëtejshme ligjore, pas zhvillimit të procedurave të konkurrimit publik nga Autoriteti Publik.

Në vemendje për zbatim kriteret e nenit 66, paragrafi i dytë si dhe neni 67, të ligjit nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”i ndryshuar, kjo sipas shkresës së strukturës së specializuar, Agjensia e Menaxhimit të Burimeve Ujore me nr.1108/1,datë.23.10.2020.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**P R E F E K T I**

**Majlinda ANGONI**

<sup>1</sup> Elementi i rinovimit të kontratës është pjesë e dispozitave të kontratës gjatë zbatimit dhe nuk duhet të jetë element i vendimarrjes sot.

